

Qendrat e Reja të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Përmet, Tropojë, Mat, Kavajë dhe Pukë kanë realizuar disa aktivitete informuese dhe sensibilizuese mbi hapjen e Qendrave, me qëllim sigurimin e aksesit në drejtësi për të gjithë qytetarët.

Kavajë

Në kuadër të aktiviteteve promovuese për hapjen e Qendrave, Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Kavajë ka zhvilluar, në datën 07.08.2023, një takim me Drejtoreshën e Institutit të të Miturve në Kavajë, znj. M.Alia, si dhe punonjësit e këtij institucioni. Gjatë këtij takimi u diskutua në lidhje me mundësinë e lidhjes së një ure bashkëpunimi, si dhe krijimin e një praktikë pune, prezenën e mbrojtësit falas në masat disiplinore të të miturve që ndodhen të izoluar në Institutin e të Miturve Kavajë.



Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Kavajë, ka zhvilluar në datën 15.08.2023 një takim me Drejtorin e Shërbimit Social dhe punonjësit e Zyrës së Dhunës në Familje, pranë Bashkisë Rrogzhinë.



Në datën 21.08.2023, Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Kavajë, ka zhvilluar një takim me Administratorin e Njesisë Administrative Lekaj, Z.A.Mema. Gjatë këtij takimi u diskutua në lidhje me mundësinë e lidhjes së një ure bashkëpunimi midis dy institucioneve.

Përmet

Në datën 24.08.2023, Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Përmet ka zhvilluar një aktivitet informues në ambjentet e një fasonerie, në qytetin e Përmetit.



Tropojë

Në datën 30.08.2023, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tropojë zhvilloi një takim në ambjentet e Njesisë Administrative Fierzë, me Administratorin Z.B.Buçpapaj dhe me specialisten e ndihmës ekonomike Zj. D.Kola.



Në datën 31.08.2023, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tropojë, në bashkëpunim me Bashkinë Tropojë, zhvilloi një takim informues me qytetarë përfitues të skemës së ndihmës ekonomike, të cilëve Bashkia Tropojë u ka ofruar strehim në një ambient social pa pagesë.

Pukë

Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Pukë ka zhvilluar, në datën 17.08.2023, një takim me titullaret e Institucioneve të Bashkisë Pukë, me qëllim promovimin e Qendrës Juridike Parësore Pukë.




Takime dhe aktivitete të zhvilluara gjatë muajit Gusht 2023 nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, me qëllim sigurimin e aksesit në drejtësi për të gjithë qytetarët

Mat

Qendra e Ndhmës Juridike Parësore Mat ka zhvilluar disa takime, me qëllim promovimin për hapjen e Qendrës.

- Takim informues dhe promovues në Kopshtin e Qytetit;
- Takim informues dhe promovues me qytetarët e Komunitetit Rom;
- Takim informues dhe promovues me drejtuesit e IEVP-Burrel;
- Takim informues dhe promovues në Njësine Administrative Baz, të Rrethit Mat.
- Takim informues dhe promovues me Drejtorin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Takim informues dhe promovues me psikologin e Spitalit të Burrelit;
- Takim informues dhe promovues në Komisariatin e Policisë Mat;



- Realizimi i njoftimit për Hapjen dhe funksionin e Qendrës, në Televizionin lokal Tv Mat.

<https://youtu.be/p03Jrkpgl8A?si=w3Zr7MFhMuvBdh8g>

Elbasan



Në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere, në datën 25.08.2023 Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Elbasan ka zhvilluar një takim me Kryetarin e Degës së Shoqatës së Para & Tetraplegjikëve, të Qarkut Elbasan Z. D. Hoxha, në ambientet e shoqatës.

Korçë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë, në datën 11.08.2023, ka zhvilluar një aktivitet informues në bashkëpunim me Bashkinë Korçë, Shërbimin e Provës, Zyrën e Punës, Drejtorinë e Kujdesit Social, etj. Në fokus të takimit ishin gratë e dhunuara, si kategori e veçantë, të cilat kanë nevojë për mbështetje dhe përkrahje.



Gjirokastër

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Gjirokastër ka zhvilluar në datën 10.08.2023, një aktivitet pranë Zyrës së Gjendjes Civile, pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastër. Ky aktivitet konsistoi në informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, shërbimet e mbuluara tërësisht nga buxheti i shtetit, si dhe bashkëpunimi ndërinstytucional për referimin e rasteve.

Fier

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier ka zhvilluar një aktivitet, në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimin të qytetarëve. Ky aktivitet u zhvillua pranë ambienteve të zyrës me pjesëmarrjen e qytetarëve nga komuniteti Rom, ku u evidentua një rast për përfimin e ndihmës juridike dytësore.



Berat

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Berat, në datën 23.08.2023 ka zhvilluar një aktivitet informues, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Berat.



Takime dhe aktivitete të zhvilluara gjatë muajit Gusht 2023 nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, me qëllim sigurimin e aksesit në drejtësi për të gjithë qytetarët

Durrës

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Durrës, në datën 24.08.2023, ka organizuar një aktivitet në formën e "Street Law" me temë "Promovimi i ndihmës juridike falas, si pjesë e së drejtës së aksesit në drejtësi". Nga ky aktivitet u realizua shpërndarja e fletëpalosjeve dhe materialeve informuese, si dhe u bë i mundur takime me qytetarë.



Pogradec

Në vijim të bashkëpunimit midis Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Shërbimit të Provës, u zhvillua një takim i përbashkët në degën Pogradec, ku u diskutua për vijimin e bashkëpunimit mbi kategoritë përfituese, pjesë të ligjeve respektive.



Kukës

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Kukës ka realizuar një intervistë, lidhur me ecurinë e qendrës, rastet e trajtuara si dhe aktivitetet e realizuara për promovimin e Qendrës.



<https://www.facebook.com/watch/?v=201503649592520>

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Kukës, në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese, ka realizuar aktivitetin me fokus kategoritë e veçanta, kryesisht personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me përfaqësues të institucioneve, Avokatin e Popullit Zyra Rajonale Kukës Z.Billa, Av.M.Zenelaj, punonjës të Shërbimi Social, Bashkia Kukës.



Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Kukës ka realizuar trajnimin me temë "Advokimi dhe Rrjetëzimi", organizuar nga Shoqata e Invalidëve Para dhe Tetra-Plegjikë, lidhur me të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.


Shkodër

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Shkodër, në datën 31.08.2023 ka zhvilluar një aktivitet promovues me qytetarë të qytetit.



Lezhë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lezhë, në datën 25.08.2023 ka zhvilluar një aktivitet promovues në zona të ndryshme të qytetit, duke informuar qytetarët, si dhe emigrantët të cilët shprehën interes për familjarët, prindërit e tyre.



Lushnjë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lushnjë, në datën 28.08.2023 ka zhvilluar një aktivitet promovues me qytetarë të qytetit Lushnjë, të cilët ndodheshin për shërbime të ndryshme pranë Njësisë Administrative Nr. 2, Bashkia Lushnjë.



Vlorë

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë, në datën 15.08.2023, në kuadër të fushatës ndërgjegjësuese dhe informuese në bashkëpunim me Kryetaren e Qendrës "Për zhvillim dhe ndryshim" znj.T.Memushi. Aktiviteti u zhvillua në terren dhe në këtë formë, u gjendëm më pranë qytetarëve, të cilët kanë problematika të pazgjidhura dhe që përmbushin kriteret për të përfituar ndihmë falas.

